

STATUT
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“PRO GREEN”

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.Sot me datë 12.03.2021 Unë themeluesi, kam krijuar, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “PRO GREEN” shpk.

2.Themeluesi i Shoqërisë:

- **Ervis Cenaj**, atësia Hysni, i datëlindjes 21.03.1983, identifikuar me kartë ID me nr. Personal I30321124Q, lindur në Fushë-Arrëz dhe banues në Rrugë “Skrapari”, Nd nr 7, Kamëz.

3. Të dhëna të kontaktit:

Email: progreen.shpk@gmail.com

Tel: 0693698988

Neni 2

Objekti

1.Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi. Punime dheu, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme e kompletimi me instalimet e nevojshme, ndertime civile, industriale, turistike, ndertim rruge, fusha aviacioni, veshje me asfaltobeton te rrugeve, ndertim veprash arti, ndertim ujesjellesash e kanalizime. Punime karpentjerie metalike, shpim pusesh gjeologjike inxhinierike e hidrogjeologjike etj. Rivelime dhe punime topogeodezike etj. Veprimtari financiare te transferimit te parave ne emer dhe per llogari te Subjektit Financiar-Jobanke. Veprimtari te Agjentit Komisioner. Ne fushen e Projektimit te ndertimit. Prova laboratorike ne strukturen ndertimore. Vepër hidroteknike, marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibriporta e pontile. Konsulence Juridike, import-eksport mineralesh. Auditim ne finance dhe auditim ne ndertim. Hartim i raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, auditim mjedisor, hartim i ekspertizave per probleme mjedisore. Ekspert privat zjarrfikes. Master plane studime plane rajonale urbanistike, plan rregullus te per gjithshem per qendera te banuara dhe qytete. Per Sherbime Espertize dhe/ose Profesionale lidhur me Burimet Energjetike. Import, eksport, shitjeblerje dhenie me qira dhe nenqira automjetesh dhe ambjentesh. Vleresim i pasurive te paluajtshme. Projekte dhe Studime Urbanistike. Projekte e ndertime civile, industrial turistike, bujqesore. Studime ambientale, projekte interieresh, projektim peisazhi e sistemimi. Studime e projekte hidrogjeologjike, projekte rruge, ura, porte turistike, te inxhinierise elektrike, inxhinierise hidromekanike, projekte konstruktive restaurime si dhe konsulencia per temat e mesiperme. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim strukturash beton arme, metalike, projektim autostrada heliporte dhe aeroporte. Projektim linjash dhe sistemesh te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, ujesjelles kanalizime, vepër ujite, kullimi impiante vaditese, diga dampa; projektim vepër naftesjelles, gazsjelles etj. Projektim fotogrametik, hartografik, topografik, konsulencia tekniko ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi qe nuk permendet me siper. Menaxhim dhe koordinim i projekteve te ndryshme,



konsulencia te ndryshme ne lidhje me sherbimet e mesiperme. Shërbime ndërhyrëse në raste emergjencash I.2.B. Çertifikim, menaxhim të eficencës së energjisë në ndërtesa, godina industriale dhe në transport. Imp-eksport, prodhim tregtim materiale ndertimi, industriale e ushqimor, ashensore, mirembajtje ashensoresh etj. Transportim mallrash e pasagjeresh, brenda dhe jashtë vendit. Grumbullim te bimeve medicinale. Ndertimi, operimi i Hidrocentraleve deri ne shitjen e energjise se prodhuar. Grumbullimi dhe Transporti i Mbetjeve inerte. Trajtim/ magazinim ose trajtim i mbetjeve te tjera te ujrate te zeza urbane, ujrat e ndotura, llumin septik, mbetjet e ujrate te zeza. Ndertime civile dhe ekonomike, ndertime civile, industriale turistike, buqesore te lartesive te ndryshme rikonstruksione, ndertim banese me skelet mbi 8 kate. Ndertime, mirembajtje rrugore, te kategorive te ndryshme, Ndertim autostrade-pista-aeroporte-helioporte. Ndertim hekurudhore, punime speciale te shinave dhe traversave, punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit. Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10m dhe mbi 10m. Ekstrakada-ura metalike te varura, ndertim tunele rrugore-hekurudhore, ndertime detare, ndertime portuale-banki ena-basene-pontile, punime thellimi etj. Ndertime hidraulike, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje te sistemit hidraulik-cimentime etj. Ndertim impiante te sistemit te ujit, ndertim vajsjelles, gazzjelles, naftesjelles, ndertim diga-damba deri ne 10m, ndertim galeritunele, ndertim diga te larta. Vepra te vecanta punime speciale, sillose, kulla, kulla uji etj. B/arne metalike, perforcime themeli e punime nentokesore, izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat, themele te veçanta, puse shpime gjeologo-inxhinjerike, çpime per uje. Punime restaurimi, restaurim i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike. Punime sherbimi, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe-pyll, pastrimi i siperfaqeve urbane, mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mqedise urbane-ndriçimi e sinjalizimi urban.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

1. Shoqëria është krijuar për një periudhë kohe të pacaktuar.

2. Vendimet, për shpërbërjen e hershme të shoqërisë, merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve 30 ditë para vendosjes për shpërbërje.

**Neni 4
Selia**

1. Selia e regjistruar e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Kavajës", Qendra "Sun Tower", Kati 8, Ap.30, Tiranë, Shqipëri.

**Kreu II
Kapitali**

**Neni 5
Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është 100 Lekë.

1. Ortaku themelues, **Ervis Cenaj**, është zotëruesh i një kuote, me vlerë të përgjithshme 100 Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. I nënshkruari ka kontribuar për shoqërinë si më poshtë :

Kontribut monetar

Ervis Cenaj - 100 Lekë



Kontribut të mirash të ndryshme

- s'ka
- kontribut në natyrë
- s'ka

Neni 6 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

1.Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar pér kontributet në para, dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

2.Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njejtat kushte që kërkohen pér ndryshimin e statutit.

3.Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë, ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i Kapitalit

1.Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2.Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, por duke ezauruar si procedure fillestare të drejtën e parablerjes.

Kreu III Organet Vendimmarrës dhe Drejtuese

Neni 8 Organi Vendimmarrës

1.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

2.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

3.Asambleja e Ortakëve, është përgjegjëse pér marrjen e vendimeve pér shoqërinë, pér çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve pér personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4.Ortaku mund të përfaqësohet në Asambleën e Ortakëve, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.
- 5.Administratori, nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asambleën e Ortakëve. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve

1. Asambleja e Ortakëve, thirret, nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik, duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë, përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
2. Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm, nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të "Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse Asambleja e Ortakëve nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

1. Asambleja e Ortakëve, vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Për cështjet e tjera të përmendura në nenin 8, Asambleja e Ortakëve, vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Cdo ndryshim statuti duhet të regjistrohet ne QKB, për të pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes, nëse Asambleja e Ortakëve merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

1. Asambleja e Ortakëve, emëron si administrator Z. **Erviz Cenaj**, identifikuar me anë të Kartës ID me nr personal I30321124Q, për një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

Nënshkrimi

ERVIS CENAJ 

Neni 14
Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakëve;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset përmbraktuar mbajtjen e saktë, e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë Asamblesë së Ortakëve përmiratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi, në kohën e duhur, përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- e) raporton përparrë Asamblesë së Ortakëve, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve kur:

- sipas bilancit vjetor, apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme, brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë, apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 15
Përgjegjësitet e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

2. Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme përmes besnikërinë, sipas neneve 14, 15, 17, e 18 të ligjit "Përmes Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj, ose në statut, në mirëbesim, e në interesin më të mire të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrë;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj, ose në statut, vetëm përritjen e qëllimeve të

përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi, çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve, sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
dh) të ushtrojë detyrat e tij, me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

3.Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat, dhe shkel standartet profesionale të caktuara më sipër, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, si dhe të kalojë cdo përfitim që ai apo persona të lidhur me të, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

4.Administratori është përgjegjës, edhe për cdo detyrim tjëtër, që nuk është parashikuar shpehimi i këtë statut, por që rrjedh nga ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 16 Viti Financiar

1.Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar, dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë ne QKB, dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Kreu IV Prishja/Riorganizimi i shoqërisë

Neni 17 Prishja/Likuidimi i Shoqërisë

1.Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet, dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

2.Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë.

3.Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brënda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar, mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18 Riorganizimi i Shoqërisë

1.Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit te mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore, të parashikuara në pjesën IX të ligjit, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 19 Baza ligjore

1.Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, në përputhje me këtë statut, dhe legjislacionin shqiptar.

2.Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe cdo ligj tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Mosmarrëveshjet

1.Për mosmarrëveshjet që mund të lindin, për zbatimin e interpretimin e këtij statuti, si dhe cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të trëtëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

Ortaku
i Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar
“PRO GREEN” Sh.p.k

Ervis Cenaj

